



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Letërsi e Gjuhës B (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 45 orë mësimore; 30 leksion /15 seminare
Viti / Semestri : Viti II ,semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore: Studenti duhet të jetë i aftë: Të përfitojë njohuri të përgjithshme lidhur me zhvillimet letrare, sociale, politike, ekonomike dhe kulturore, që karakterizojnë shoqërinë italiane të shek. XVII - fillim shekullin XIX. Të njohë letërsinë italiane të shek. XVII - fillim shekullin XIX. dhe rolin e shkrimtarëve kryesorë të periudhës; Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi momentet kyçe të letërsisë & kulturës italiane të shek. XVII - fillim shekullin XIX

Objektivat specifike lëndore:

1. Përvetësimin nga ana e studentëve të njohurive të plota si edhe krijimin e një këndvështrimi historiko-kritik të letërsisë italiane të shek. XVII- fillim shekullin XIX. Strukturimi paraqet një lexim diakronik të traditës lirike italiane të shek. XVII- fillim shekullin XIX, temën e peizazhit në letërsi në shek. XVIII.
2. Kursi synon një përvetësim fillestar të njohurive metodologjike dhe kritike në lidhje me didaktikën e letërsisë italiane. Për këtë arsye do t'u kushtohet një vëmendje e vecantë përdorimit të teknikave dhe mjeteve didaktike në qasjen ndaj tekstit.
3. Synohet formimi i një studenti kompetent ndaj nevojave gjuhësore që parashtron sot në mënyrë të pashmangshme bota e komunikimit dhe e mediave; i aftë të bashkojë në mënyrën e duhur aksin gjuhësor me atë kulturor e letrar; në gjendje të përshkojë i sigurt itineraret kulturore të së shkuarës, duke zotëruar mirë njohuri letrare, gjuhësore, historike dhe artistike të traditave në të cilat bazohet formimi i kulturës evropiane.

Rezultate të pritshme:

1. Aftësia për analiza letrare të periudhës përkatëse.
2. Aftësia për të ushtruar mendime analitike, kritike dhe logjike në interpretimin e dukurive të ndryshme letrare.
3. Aftësia për të njohur proceset letrare-kulturore italiane të shek. XVII - fillim shekullin XIX.
4. Aftësia për t'i përshkruar veprat letrare të autorëve italianë të shek. XVII - fillim shekullin XIX. në mënyrë analitike duke përdorur terminologjinë specifike të fushës letrare.